

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	E reja zbuloi SKANDALIN, Zegjineja thyen heshtjen për ngjarjen me dajën: I ati i Meritës ishte kundër! D ënoj çdo lloj dhune (REAGIMI)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/e-reja-zbuloi-skandalin-zegjineja-thyen-heshtjen-per-ngjarjen-me-daje-i401282
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:22:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4bc09f274bc0816a66a76b883009371a508accb98225a4cbe309e3a630dde55f
TEKSTI	08305099066dcdbb8bac39113e244317d9077dff53f8d99f8ab3653cfd12b3fd
PAMJA	d9ba222f1f16e0f92418e02306d64390d163d2f799ac0b959b8cdf7cc024d204

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3c6d5462f11c50a73050af0cec0d27f26e4336d68d8dfa1df808f9688786698b
E MËPARSHMJA	095106e70774690ea36297a8a0cd7597d05bc29607604f52bcedc65763bd5771
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3c6d5462f11c50a73050af0cec0d27f26e4336d68d8dfa1df808f9688786698b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

15 Shtator 2026, 19:16

E reja zbuloi SKANDALIN, Zegjineja thyen heshtjen për ngjarjen me dajën: I ati i Meritës ishte kundër! Dënojnë çdo lloj dhune (REAGIMI)



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Zegjine Caushi, dhe foto e postuar prej saj: daja i deputetes dhe ish-bashkëjetuesja e tij

Deputetja socialiste Zegjine Çausi ka bërë një reagim publik lidhur me ngjarjen e ndodhur dy ditë më parë në Roskovec, ku daja i saj plagosi me drapër ish-vjehrrin.

Sipas Çausit, ajo e ka takuar vëllain e nënës së saj rastësisht në qershor, teksa ishte duke zhvilluar takime në zonë, pasi ka dëgjuar për marrëdhënien e tyre ajo thotë se i ka uruar. Dhe më tej së bashku me një kushër të pranishëm e kanë pyetur Merita Gremajn "e keni ndarë mendjen? Do martoheni?", e pasi Gremaje ka pohuar këtë duke anashkaluar mendimin e të atit, Çausi është shprehur "Se mos na hapni probleme", referuar pëlqimit të babait.

Po ashtu deputetja përmes reagimit të saj duket se lë të kuptohet që si daja i saj, ashtu edhe ish-bashkëjetuesja e tij do të duhet të trajtohen psikologjikisht.

"Në të njëjtën kohë, mendoj se ky është një rast që duhet të trajtohet me seriozitet e kujdes edhe nga këndvështrimi psikologjik, për të dy personat, me qëllim gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe parandalimin e çdo përshkallëzimi të mëtejshëm.", ka shkruar Çausi.

Ajo thekson se ka qëndruar tje për vetëm 10 minuta dhe për ngjarjen është informuar

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Edi Rama dhe Sali Berisha kalojnë sërish oqeanin, kryeministri do takohet dhe me diasporën shqiptare, pritjet të dekorohet me çmim nga Trump (DATAT-DETAJE)



Rajoni

Sherri për bonxhet "lanë" me gj"k lagjen turistike në Stamboll, tre të vrarë dhe një i plagosur (PAMJE)

Zbuloj më shumë artikuj >

nga mediat. "Për këtë ngjarje jam informuar përmes mediave, njësoj si opinioni publik. Dua ta them shumë qartë: dënoj me forcë çdo formë DHUNE, pavarësisht se nga KUSH është ushtruar.", shprehet deputetja socialiste.

Deputetja po ashtu ka postuar një foto të dajës së saj dhe ish-bashkëjetueses së tij.



Bledar Bakaj dhe Merita Gremaj

Kujtojmë se mbrëmjen e 13 shtatorit, daja i Zegjine Çaushtit, Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashkëjetueses së tij Merita Gremaj, dhe plagosi me drapër ish-vjehërrin e tij. Pas ngjarjes dha një deklaratë për mediat vetë Gremaj e cila pretendoi se ishte dhunuar, përdhunuar dhe mbajtur me forcë nga Bakaj për 45 ditë.

"Shumë, shumë e ngarkuar. Kam nevojë urgjentisht për psikolog. Kam përjetuar tmerr, tmerr. Më ka dhunuar, më ka kërcënuar, me ka përdhunuar, nuk mundem më", ka dëshmuar Merita, teksa më tej ka folur edhe për takimin me deputeten.

"E kam takuar. Pas dy ditësh erdhi. (Dy ditë pasi kishte ndodhur pengmarrja dhe Merita mbahej me dhunë në shtëpinë e Bledar Bakaj). E mori përjashta dhe i tha "qysh e ke marrë". Ai i tha "atë e di unë", është shprehur Merita teksa më tej tha se se pasi deputetja Zegjine Çaushti ka marrë këtë përgjigje nga daja i saj, i ka pohuar: "Do na fus në telashe, i tha."

Reagimi i plotë i Zegjine Çaushtit:

Duke iu referuar ngjarjes së ndodhur në fshatin Suk 2 dhe të publikuar nga mediat më 14.09.2026 dhe 15.09.2026, dëshiroj të sqaroj opinionin publik lidhur me informacionet e dhëna deri tani.

Familja e nënës sime përbëhet nga 11 fëmijë: 9 motra dhe 2 vëllezër. Të gjithë kanë familjet, punët dhe jetët e tyre, ndaj natyrshëm nuk kemi kontakte të vazhdueshme dhe të pandërprera me njëri-tjetrin.

Vëllain e nënës, Bledar Bakaj, së bashku me znj. Merita Gremaj, e kam takuar rastësisht pas një takimi që kisha në atë zonë, në fillim të muajit qershor. Kam kaluar pranë banesës dhe kam parë të afërm dhe fqinjë, rreth 10-15 veta, në oborrin e banesës. Madje, aty kam takuar edhe një kushëri, të cili Merita Gremaj e kishte njeriun e afërt nga fisi i të atit.

Sapo kam hyrë në oborr kam parë Meriten, e cila m'u prezantua si bashkëjetuesja e Bledarit. I urova padyshim për lidhjen e tyre, pasi atë gjë po bënin edhe fqinjet që ishin prezent dhe më pas, si unë, edhe kushëririn im iu drejtuan: "E keni ndarë mendjen? Do

Merita Gremaj tha : "Po po, i kam marrë parasysh kushtet në të cilat Bledari jeton, edhe pse babai s'e ka me qejf..."

"Se mos na hapni probleme", iu drejtova pas fjalëve të saj, referuar pelqimit te babait. Gjëja kaloi me të qeshura dhe urime nga njerëzit e pranishëm.

Kam ndenjur rreth 10 minuta dhe kam levizur për angazhimet e mia, të tjerët kanë vazhduar të qëndronin.

Pas disa ditësh, pashë edhe në rrjetet sociale, fotografi të tyre së bashku, të qeshur dhe me lule në duar.

Ky është i gjithë informacioni që kam pasur dhe kam në lidhje me marrëdhënien e tyre.


Për këtë ngjarje jam informuar përmes mediave, njësoj si opinioni publik.

Dua ta them shumë qartë: dënoj me forcë çdo formë DHUNE, pavarësisht se nga KUSH është ushtruar.

Në të njëjtën kohë, mendoj se ky është një rast që duhet të trajtohet me seriozitet e kujdes edhe nga këndvështrimi psikologjik, për të dy personat, me qëllim gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe parandalimin e çdo përshkallëzimi të mëtejshëm.

Për pjesën tjetër, organet ligjzbatuese duhet të bëjnë punën e tyre.

Këshilluar për ty



"Do na fus në telashe", rrëfimi me VIDEO i Meritës zbulon SKANDALIN, deputetja Zegjine Çausi e dinte për vajzën që daja i saj mori peng dhe e përdhunoi, i shkoi në shtëpi



"Nuk mundem më, dua ndihmë", Merita e tronditur, rrëfen tmerrin me dajën e deputetes Zegjine Çausi: Më përdhunoi, 45 ditë më mbajti peng në shtëpi (VIDEO)



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





🕒 E Martë 17:50

I dënuar për dhunë, arrestohet 44-vjeçari shqiptar në Itali



Aktualitet

Apeli i dha lirinë në 2020, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim dosjen e Ergys Kolaverit, donte të merrte gjakun e vëllezërve

🕒 E Martë 17:31 Newsbomb



Aktualitet

MIRATOHET drafti i PS për pagat e magjistratëve të "Ligjet", kalon në Kuvend këtë të enjte

🕒 E Martë 17:16



🕒 E Martë 17:15

Aksident i rëndë në Lezhë-Shkodër! Përplasen tre makina, raportohet për tre të plagosur (PAMJE NGA VENDNGJARJA)



Aktualitet

Aksident i rëndë në Maqellarë-Peshkopi, plagosen pesë persona,



Aktualitet

U arrestua dy muaj më parë, Gjykata e Tiranës vendos për ekstradimin e

kater prej tyre nisen me urgjence
drejt Tiranës

🕒 E Martë 17:11 Newsbomb

turkut te akuzuar per tentative vrasje
në Zvicër (EMRI)

🕒 E Martë 16:34



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.